



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[03.08.2020]

**BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË**

**“GJOKA KONSTRUKSION” & “COBIAL” & “GR ALBANIA” & “GEO PORTAL”**

**Rruga “Dora D`Istria” Hyrja 1 dhe Hyrja 2, Tiranë**

**Procedura e prokurimit: Pune/ Procedure e Hapur**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-19520-04-24-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: «Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7», me fondin limit 2.332.573.946 Lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së). Afati i kontrates 24 muaj**

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 30 Prill 2019 [Nr.17]**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. “Alb Building” & “BE-IS” & “F & S” & “C.E.C Group &” Nord – Comat”  
NUIS: J69102508C / K71412003A / K71620004I / L11807013M L08501501Q  
Vlera: 2.295.400.000 (dy miliard e duqind e nentëdhjete e pese milion e katerqind mije) Leke**
- 2. “Fusha” & “Aydiner Inssat Anonim Sikerti” & “Gjeokonsult & Co”  
NUIS: J61900018S / L11915006D / K91810005U**



**Vlera: 1.959.595.959** (nje miliard e nenteqind e pesedhjete e nente milion e peseqind e nentehjete e pese mije e nenteqind e pesedhjete e nente) leke

**3. “Gener 2” & “SEEDC Consulting” & “Infra Konsult””**

**NUIS: K38207306V / L41824014Q / K58615301M**

**Vlera: 2.077.280.578,13** (dy miliard e shtatedhjete e shtate milion e dyqind e tetedhjete mije e peseqind e shtatedhjete e tete presje trembedhjete) leke

**4. “Gjoka Konstruksion” & “Cobial” & “Gr Albania” & “Geoportal”**

**NUIS: J91815014U / K02715414M / L01509004N / L62115002A**

**Vlera: 1.789.598.000** (nje miliard e shtateqind e tetedhjete e nente milion e peseqind e nentehjete e tete mije) leke

**5. “IRCOP” & “Sulova Ndertim Prodhim” & “Vega “& “A & E Engineering”**

**NUIS: L91709039U/ L43027201P / K01524006L / K72113010E**

**Vlera: 2.299.327.253,75** (dy miliard e dyqind e nentehjete e nente milion e treqind e njetete e shtate mije e dyqind e pesedhjete e tre presje shtatedhjete e pese) leke

**6. “PE VLA KU “ & “A L T E A” & “GEO Studio 2000”& “TAULANT” & SPHAERA**

**NUIS: K61716013M / J62026003M / K61617040L / J81809003U**

**Vlera: 1.889.384.779** (nje miliard e teteqind e tetedhjete e nente milion e treqind e tetedhjete e kater mije e shtateqind e shtatedhjete e nente) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “Alb Building” & “BE-IS” &”F &S” & ”C.E.C Group &” Nord – Comat”**

**NUIS: J69102508C / K71412003A / K71620004I / L11807013M L08501501Q**

**2. “Fusha” & “Aydiner Inssat Anonim Sikerti” & “Gjeokonsult & Co”**

**NUIS: J61900018S / L11915006D / K91810005U**

**3. “Gener 2” & “SEEDC Consulting” & “Infra Konsult””**

**NUIS: K38207306V / L41824014Q / K58615301M**

**4. “IRCOP” & “Sulova Ndertim Prodhim” & “Vega “& “A & E Engineering”**

**NUIS: L91709039U/ L43027201P / K01524006L / K72113010E**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1. Bashkimi i operatoreve “Alb Building” & “BE-IS” &”F &S” & ”C.E.C Group &” Nord – Comat” , rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kritereve per kualifikim dhe kerkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT .**



a. Asnje prej pjesetareve te BO qe disponojne license ne fushen e projektimiti nuk ka arritur te paraqese dokumentacion se ka kryer sherbime ne tre vitet e fundit me natyre te ngjashme me natyren e sherbimeve qe kerkohen ne kontraten objekt prokurimi , cka perben mosplotesim te pikes 2.3.6 te kriterëve te vecanta per kualifikim . ( Operatori ekonomik duhet të kenë realizuar kontrata projektimi të ngjashme me objektin që prokurohet tre vitet e fundit me vlerë jo më pak se 15 000 000 leke pa TVSH.)

Nga dokumentacioni i dorezuar rezulton se , nga subjektet pjese e BO ofertues i vetem operatori F & S shpk disponon license projektimi me kategorine 7/e (Tunele rrugore – hekurudhore).

Per te dshmuar plotesimin e ketij kriteri , operatori F&S shpk ka paraqitur kontrate me ARRSH ku eshte kontraktor si pjese e nje BO me object “ Studim projektim by pass Gjrokaster “ .Kjo kontrate nuk perfshin sherbim per hartim projekti tunel tokesor , pra sherbime te parashikuara ne piken 7/e te licenses .

Kontrata object prokurimi , sipas termave te references dhe preventivit paraparak , parashikon se zerat kryesore te punimeve perfshijne ne shumice absolute punime per ndertim tuneli tokesor .

Por edhe referuar preventivit te ofertes se paraqitur nga operatori , vete operatori ka parashikuar se punimet ne tunel perfshijne me shume se 80 % te vleres se pergjithshme te vleres totale te ofertes . ( punimet ne tunel ka parashikuar vleren 1 818 000 leke pa tvsh kurse vlera totale eshte 2 295 400 leke pa tvsh )

Ne keto kushte , eshte e kuptueshme se operatori qe zoteron license ne fushen e projektimit per te dshmuar plotesimin e pikes 2.3.6 te kriterëve te vecanta per kualifikim do duhej te kishte paraqitur kontrata qe perfshijne projekt per tunele .Kontrata e paraqitur nga operatori F & S shpk ( hartim projekti per ndertim By passi ) , nuk mund te kosnderohet me natyre te ngjashme sepse zerat kryesore te sherbimeve te realizuara ne ate kontrate pavaresiht emertimeve nuk kane natyren e punimeve qe perfshin ndertimi I nje tuneli . Aftesite profesionale , eksperiencia e nevojshme per hartim projektit te ndertimit te nje tuneli dallon thelbesisht e ka natyre specifike krejtisht te pangjashme me natyren e ndertimit te rruges qofte edhe by passi.

Perderisa operatori nuk I ka shfrytëzuar drejtat e tij oparashikuara nga neni 42 I LPP per te kerkuar sqarime lidhur me kete kriter apo te paraqiste ankese sipas nenit 63 te LPP ( madje ne ankesen e paraqitur nuk e perfshinte kete pike ) , atehere ne zbatim te rregullave te prokurimit publik ka qene I detyruar të përgatiste e paraqiste oferten , në përputhje te plote me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe mqs kjo oferte nuk I ploteson ato ajo duhet të refuzohet si e papranueshme.

b. Dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisht (kontrata e bashkëpunimit dhe preventivi i paraqitur) nuk janë hartuar sakte dhe në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII pika 2 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, ndaj operatori duhet te skualifikohet .

Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 2 të VKM 914/2014 parashikohet se :



- "1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. ....

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri , operatori ka paraqitur kontraten noteriale te bashkepunimit nr 3119 rep date 15.06.2019 .

Ne nenin 3 dhe 6 te kesaj kontrate eshte percaktuar se Alb Building do te kryeje 90 % te punimeve te zbatimit kurse BEIS shpk do te kryeje 10 % te puneve . Kurse ndarja e sherbimeve te projektimit do te jete ;F & S shpk do te jete 42.5 % , C E C Group shpk 42.5 % dhe Nord Comat shpk 15 % .

Kjo menyre ndarje nuk eshte ne perputhje me percakimet e pikes 2 te VKM 914/2014 .Kjo sepse operatori ka bere nje ndarje qe nuk I referohet vleres totale te ofertes dhe % e pjesemarrjes te sejcilit pjesemarres ti refrohet vleres totale te ofertes por " shpik " nje menyre te re ndarje te pambeshtetur ne rregullat e prokurimit duke shkeputur pjese te preventivit e duke mos e trajtuar ate ( preventivin ) si nje te tere nga ku do dale % konkrete qe do te kryente sejcili prej pjesetareve te BO por , te perbere nga dy preventive te vecante sikur te ishim ne nje procedure me lote ( nje preventiv qe sheben si preventiv I punimeve te zbatimit dhe nje preventiv tjetër si preventiv i sherbimeve te projektimit ) .

Ne fakt , AK ne DT dhe neni 74 I VKM kane percaktuar dhe paraqitur vetem nje preventiv te vetem dhe % e pjesemarrjes ne rastin e bashkimit te operatoreve duhet ti referohet vleres totale te preventivit jo pjeseve te vecanta te tij.

Referuar kesaj menyre ndarje te operatorit, KVO e ka te pamundur te zbatoje percaktimet e pikes 2 te nenit 74 te VKM 914/2014 , per te vleresuar plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim ne perputhje me % e marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit.

5.3 Operatori nuk ka arritur te deshmoje se ka paraqitur dokumentacion te plote dhe te sakte per te provuar plotesimin e pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim .( nje nga operoret konkretisht Alb Building shpk nuk ka arritur te paraqese te plote dokumentacion e kekruar per te deshmuar per punet e ngjashme ).

Ne kete pike 2.3.1 eshte kerkuar ;

a. Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

ose

b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit te jetë jo me e vogel se dyfishi i e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.



Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit. Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.

2.3.1.b Në rastin e pervojes se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontrate e nenshkruara nga palet, Lejen e ndertimit, situacionet perfundimtare, akt kolaudimi te objektit.

Per te deshmuar plotesimin e kesaj pike , operatori ALB Building shpk ka paraqitur nenkontraten e lidhur me Combine Group Contranting Kuvait me object “Ndertim I rruges Qukes Qafe Plloce seksioni Tirane Korce seksioni 2 nga km 18 deri km 33.8” , dhe me Punedhenes Autoritetin Rrugor Shqiptar .

Ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori per te deshmuar se ka kryer punime te ngjashem per ndertim tuneli , operatori ka paraqitur edhe nje formular vleresimi te leshuar nga kontraktori Combine Group Contranting Kuvait me daten 17.12.2018 ku ne nje nga rubricat e ketij formulary konfirmohet se kane perfunduar punimet per ndertimin e tunelit ne masen 92 % me vlere toale prej 17 806 190 USD pa tvsh te realizuara nga Alb Building shpk .

Por ky dokumentacion I paraqitur nuk eshte I plote dhe sic eshte kerkuar ne piken 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim.

Kjo sepse , Operatori nuk ka arritur te paraqese nje nga dokumentat e kerkuar sic eshte akt kolaudimi .

Mosparaqitja e akt kolaudimit me se pari , perben mosparaqitje te plote te dokumentacionit te kerkuar ne DT te cilin operatori ishte I detyruar ta paraqiste te plote sic I eshte kerkuar ne Kriteret per kualifikim .

Por kjo mosparaqitje nuk eshte vetem formale thjesht e vetem te mos paraqitjes se nje dokumenti te kekruar por qe mudn et zevendesohet infomarcioni qe ai percjell nga dokumenta te tjere . .

Ne fakt mungesa e ketij dokumenti ( akt kolaudimit ) eshte edhe nje mospermbushje thelbesore e dokumentacioni qe sipas ligjit sherben per te deshmuar perfundimin e nje objekti ndertimor e qe me tej mund te paraqitej nga operatori si deshmi se ka kryer punime te ngjashme per ndertim tuneli tokesor.

Domosdoshmerine e paraqitjes se akt kolaudimit dhe qe informacioni qe ai paraqet nuk mund te jepet nga dokumentacion tjeter e deshmon edhe fakti se , ne koken e formularit te vleresimit percaktohet se; ky formular eshte I vlefshem kur shoqerohet kumulativisht me akt kolaudimin dhe situacionin perfundimtar .

Mos shoqerimi I formularit te vleresimit me akt kolaudimin e ben edhe ate formular te pavlefshem , cka praktikisht do te thote qe operatori nuk ka paraqitur akt kolaudim dhe formular vleresimi .

Moskryerja e kolaudimit te objektit sipas percaktimeve ligjore te zbatueshme gjate zbatimit te punimeve ne ndertim , konsiderohet mospermbushje e sukseshme e punimeve dhe mosperfundim I objektit.

Mungesa e paraqitjes se akt kolaudimit deshmon se objekti nuk ka perfunduar dhe ne kuptim te rregullave te prokurimit publik por edhe praktikes se vendimarrjeve te KPP vleresimi I



kontratave per pune te ngjashme behet vetem per objekte te perfunduara ( te kolauduara ) dhe jo per kontrata ne process zbatimi punimesh.

Neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 6 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe **ÇDO LLOJ DOKUMENTI TJETËR, QË PARASHIKOHET NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, PËR TË VËRTETUAR PËRMBUSHJEN E SUKSESSHME TË PUNËVE**

Neni 12 I ligjit 8402/2008 “ Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve ne ndertim “ , percakton qarte se kolaudimi eshte detyrim per cdo objekt ne ndertim dhe konkretisht thuhet ; Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objekti është realizuar në kushtet teknike;
2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.

Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.

Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t'ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit.

Në Udhëzimin Nr.3 datë 15.02.2001 Kreu II “Për Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” pika 7 i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

- Në përfundim të kolaudimit të veprës hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori ose grupi i kolaudimit, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Kurse ne pika II.1 thuhet

Kolaudimi i punimeve kryhet nga një specialist ose nga një grup specialistësh, ku secili duhet të ketë licencën përkatëse për specialitetin që mbulon në këtë kolaudim. Kolaudatori mund të jetë person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj.

Shprehimisht ne piken 10 te UKM nr 3/2001 thuhet ;





Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, KOLAUDATORI, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve BËJNË KONTROLLIN PËRFUNDIMTAR TË VEPRËS.

Pra , nga sa pershkruam me siper rezulton kërkesa per te paraqitur akt kolaudimin eshte e mbeshtetur ne pika 6 e nenit 26 te VKM 914/2014 ku thuhet se , “ AK kerkon çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve “ , legjislacioni ne fuqi ( ligji 8402/2008 si deh Udhezimi nr 3/2001 ) kerkon detyrimisht qe cdo objekt Brenda 30 diteve nga perfundimi duhet te kolaudohet nga persona te licensuar nga institucione tkomopetente dhe se marrja ne dorezim e objektit ka detyrimisht pjese te dosjes aktin e kolaudimit .

Moskryerja e kolaudimit sic eshte rasti konkret I tunelit te Qafe Plloces , ka ndidhur sepse ai nuk ka perfunduar dhe se nuk mund te konsiderohet perfundim I sukseshem si pune perderis anuk ka akt kolaudim . Akti I marrjes ne dorezim I paraqitur nga operatori dhe qe nuk ka nenshkrimet e mbikqyresit te punimeve dhe kolaudatorit te licensuar eshte akt abolustisht I pavlefshme dhe si I tille nuk prodhon pasoja e nuk mund te sherbeje si document se operatori ka kryer pune te ngjashme .

Por jo vetem kaq,

Punedhenes per kontraten qe operatori ka paraqitur si deshmi per pune ngjashme eshte nenkontraktim te 92 % te punimeve me object “Ndertim I rruges Qukes Qafe Plloce seksioni Tirane Korce seksioni 2 nga km 18 deri km 33.8”, eshte ARRSHja .

Nga informacioni qe morem ne njesine e zbatimit te ketij projekti( pjese e ARRSH ) na rezulton se , punimet ne tunel nuk kane perfunduar plotesisht , ne terresine e vet kontrata nuk eshte perfunduar dhe se tuneli nuk eshte kolauduar dhe nuk eshte I shfrytezueshem . Tuneli ka ende shume problematika qe jane lene detyre per ti zgjidhur nga kontraktori sepse punimet ne te nuk jane te plota sipas specifikimeve teknike te projekti si dhe paramertrave te sigurise te percaktuara ne termat e references.

Per sa me siper, KVO konkludon se oferta e BO ALB Building shpk & BE IS shpk shpk & Gjeo Konsult&co shpk skualifikohet

**2. Bashkimi i operatoreve “Fusha” & “AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti” dega Tirane & “Gjeo Konsult&co” , rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kriterëve per kualifikim dhe kërkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT .**

a. Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim ,lidhur me eksperincen se ka kryer pune te ngjashme me natyren e punimeve qe parashikohen ne kete kontrate prokurimi.

4.1.a Ne sqarimin e dhene nga AK ( njesia e prokurimit ) ne pergjigje te kerkeses per sqarim te nje operatori , eshte theksuar se ne kriteret per kualifikim eshte kerkuar qe operatori duhet te disponoje *license per zbatim punimesh* ne kategorine *NP – 5/G (Punime nentokesore, ura e vepra arti.) si dhe* te license projektimi ne kategorine *7/e (Tunele rrugore – hekurudhore )* . Gjithashtu NJ P ka sqaruar cdo operator te interesuar ne [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) , eshte sqaruar se punime te ngjashme do te kosnderohen ato kontrata qe kane punime per ndertim tunel tokesore dhe jo hidroteknike.



Nderkohe qe , operatori per te deshmuar se zoteron eksperiencen e duhur per punime te ngjashme te kryera tre vitet e fundit ka paraqitur kontrate *Ndertim hidrocentralesh* ku pjese punimesh ka edhe zera per ndertim thidroteknik.

KVO gjykon se , kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet dh eksperiencen e nevojshme pe rpune te ngjashme ne në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim KVO nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por analizon në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret per kualifikim.

Ne kete aspect , operatori nuk deshmon se ka kryer punime te natyres ngjashme per ndertim tuneli tokesor.

Punimet per tunel hidroteknik nuk mund te konsiderohen te ngjashem sepse jo vetem VKM 42/2008 I perfshin keto natyra punimesh ne kategori te ndryshmete licenses ( *NP 5 per tunele tokesore dhe NP 6 per tunel hidroteknike* ) por gjithashtu ka dallime thelbesore te qennesishme ndermjet tyre.

*Kjo sepse, ne tunele tokesore perdorues , standarti I punimeve , natyra e punimeve , kushtet e sigurise dhe perdoruesit e tuneleve jane krejtesisht te ndryshem .*

*Tunelet tokesore perdoren e ne to levizin nga njerez e automjete me standart te larte sigurie e punimet ne keto tunele certifikohen sipas standarteve europiane te sigurise rrugore kurse tunelet hidroteknike nuk kane keto standarte sigurie.*

Per sa me siper, dokumentacioni I paraqitur nga operatori per deshmuar eksperienca të ngjashme të mëparshme ( tunel hidroteknik )nuk mund te behet vetëm në titullin apo objektin e kontratës së ngjashme por referuar standarteve e zerave te punes qe parashikon tuneli tokesor sic parashikon kontrata object prokurimi, nuk deshmon plotesimin e pikes 2.3.1 te kritereve te vecanta per kualifikim .

4.1.b Edhe ne rastin e supozuar se tuneli hidroteknik do te konsiderohej kontrate me punime te ngjashme perseri operatori nuk arrin te deshmoje se ploteson piken 2.3.1 te kritereve te vecanta per kualifikim. Sipas akt marreveshjes noteriale se bashkepunimit nr 3403 rep date 16.06.2019 , dhe sipas preventivit te ndarjes se punimeve , operoret kane rene dakort qe punimet ne tunel te kryhen perkatesisht 122 592 385 leke nga Fusha shpk dhe 985 233 689 leke nga partneri AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti dega Tirane .Nderkohe qe operatori Fusha shpk nuk ka arritur te paraqese asnej kontrate te ngjashme se ka realizuar punime ne tunele tokesore.

4.1.c Edhe ne rastin e supozuar e interpretuar ne menyre me te favorshme per operatorin ofertues , se punimet per tunel hidroteknik do te pranohen si te ngjashme , perseri nje nga pjesetaret e ketij BO , konkretisht operatori AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti dega Tirane shpk shpk nuk deshmon plotesimin e pikes 2.3.5 te kritereve te vecanta per kualifikim.

Keshtu , operatori AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti dega Tirane shpk , ka marre persiper te kryeje 985 233 689 leke pa tvsh punime ne tunel , nderkohe qe zoteron ne license nivelin A te kategorise NP 5 . Niveli A sipas VKM 42/2008 , parashikon punime deri ne vleren 20 milion leke , pra shume here me pak se cka marre persiepr te kryeje ky operator.





.Pra ky operator nuk zoteron disponimin e kategorise NP5 G qe do I duhej sipas VKM 42/2008 te kryente punime ne Shumen mbi 8 milion leke

Vlera e punimeve ne tunel qe ka marre persiper te kryeje operatori AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti dega Tirane shpk eshte shume here me e madhe se sa i lejohet nga niveli i kategorise qe ai disponon.

Kjo vjen kundërshtim me përcaktimet e VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar... ku shprehimisht thuhet ;..

***Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.***

***b. Operatori Fusha ka bere deklarim te rreme lidhur me plotesimin e shtojca 11 te DST***

***Keshtu ky operator ka deklaruar si pune ne process vetem dy kontrata ne Bashkien Vore dhe nej me Drejtoine nr 1 qytetit Tirane .***

Nga buletini I njoftimeve te app.gov.al verifikohet lehtesisht dhe eshte fakt I njohur boterisht e mediatiksht se operatori Fusha shpk eshte kontraktor per zbatim punimesh per Rindertim Bulevardi kryesor I qytetit Vlore , Rehabilitim I Bulevardit Zgu I pare, pjesetar I BO ne kontraten “Per projektimin ,finacimin Ndertimin , mobilinim mirembajtjen dhe kolaudimin e kater objekteve arsimore ne zonen Tirana 4”, etj

Ne DST thuhet ; . **Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim**

Per sa me siper , mbeshtetur ;

Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*”

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”..*

**Per sa me siper, Oferta e BO Fusha shpk & AYDINER INSAAT ANONIM Sikreti dega Tirane shpk & GjeoKonsult & CO ,skualifikohet.**



**3. Bashkimi i operatoreve “GENER 2” & “Infrakonsult” & “Seed consulting” rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kriterëve per kualifikim dhe kerkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT**

a. Oferta e paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomik duhet te skualifikohet bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku thuhet *“Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”*.

Operatorët gener 2 shpk , pjese e ketij bashkimi me 97 % te puneve te marra persiper, rezultojne te jete si kontraktor me ARRSH-ne, per kontraten me objekt **“Ndertim By pas Vlore”** kontrate e lidhur me daten 08.11.2018 me vlere 4 487 284 675 leke **per te cilen nuk jane perfunduar 70 % e punimeve te kontraktuara.**

Kete fakt e kane pranuar edhe vete operatori duke e deklaruar ne shtojca 11 si pune ne process pikerisht kontraten e siperpermendur.

Mosperfundimi I 70 % punimeve eshte shkak skualifikimi jo vetem I parashikuar ne VKM 42/2008 por edhe praktike e vendimarrjes se ARRSHse edhe ne procedura tjera te mepareshme prokurimi.

Skualifikimi per kete arsye ne kete procedure prokurimi iu eshte bere e ditur operatorve t sepse AK ( *njesia e prokurimit* ) , ne pergjigje te nje kerkesë per sqarim ka botuar ne [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) pergjigjen se; mosperfundimi I 70 % te fondit te prokuruar ne kontrata aktuale me ARRSH do te ishte arsye per skualifikim per cdo operator qe do te rezultonte me kete problematike.

b. Kapacitetet teknike, profesionale e njerezore te deklaruar nga gener 2 shpk shpk , rezultojne te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontraten qe ky operator ka ne proces zbatimi , cka vjen ne kundërshtim dhe deshmon mosplotesim te pikes 2.3.7/a te kriterëve te vecanta per kualifikim

c. Operatori Gener 2 shpk nuk arrin te deshmoje se ka plotesuar piken 2.2.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim lidhur me mospasjen detyrime vendore ndaj bashkive ku ushtron aktivitet.

Operatori ka paraqitur vertetimin nr 26620/1 prot date 26.03.2019 te leshuar nga Bashkia Tirane ku deshmohet se ka te paguar detyrime vendore. Fakti qe eshte ne process gjyqesor nuk I zhben keto detyrime sepse ne kriteret pe rkualifikim nuk eshte parashikuar si arsye perjashtuese kjo mundesi , sic eshet psh rasti I detyrimeve ndaj OSHEE.

d. Asnje prej operatoreve qe disponojne license ne fushen e projektimit nuk ka arritur te deshmoje plotesimin e pikes 2.3.6 te kriterëve te vecanta per kualifikim , per sa i perket



dokumentacionit qe te deshmonet se ka kryer sherbime te ngjashme per projektim tuneli qe permban kontrata object prokurimi.

Keshtu , as operatori Infrakonsult & Seed consulting shpk qe sipas akt marreveshjes kane marre persiper te kryejne sherbimin e parashikuar nga pika 7/e ( *tunele tokesore* ) te licenses se projektimit, nuk ka arritur te paraqesin kontrata te ngjashme per realizmin te sherbimit per projektim tuneli tokesor .

Shoqerite projektues e kane paraqitur sherbime te ngjashem per pergatitje e hartim studimesh per zgjerim autostrade TR DR ; Studim fizibilitetit dizajn te seksionit rruges Thumane Vore Kashar ;Projektim operim ndertim transferim autostrade interurbane kryesore tipit A me dy korsi gjatesi 33 km ; projekt per rikonstrukson rruge ne Bashkine Tirane si dhe Rikonstruksiione rruge e palestre ne bashkine Tepelene , por nuk ka arritur te deshmoje se ka realizuar sherbime per hartim projekti per ndertim tuneli tokesor , ( *e cila eshte natyra e ngjashme e sherbimeve qe kerkohen* ) te standartit te kerkuar ne DT

e. Operatori Gener 2 shpk qe ka marre persiper te kryeje punimet e zbatimit nuk ka arritur te deshmoje se ploteson piken 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim, lidhur me eksperincen se ka kryer pune te ngjashme me natyren e punimeve qe parashikohen ne kete kontrate prokurimi.

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri operatori ka paraqitur kontrate per ndertim tuneli hidroteknik.

KVO gjykon se , kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet dhe eksperincen e nevojshme per pune te ngjashme ne në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim KVO nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por analizon në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperincat e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret per kualifikim.

Ne kete aspect , operatori nuk deshmon se ka kryer punime te natyres ngjashme per ndertim tuneli tokesor.

Punimet per tunel hidroteknik nuk mund te konsiderohen te ngjashem sepse jo vetem VKM 42/2008 I perfshin keto natyra punimesh ne kategori te ndryshmete licenses ( *NP 5 per tunele tokesore dhe NP 6 per tunel hidroteknike* ) por gjithashtu ka dallime thelbesore te qennesishme ndermjet tyre.

*Kjo sepse, ne tunele tokesore perdorues , standarti I punimeve , natyra e punimeve , kushtet e sigurise dhe perdoruesit e tuneleve jane krejtesisht te ndryshem .*

*Tunelet tokesore perdoren e ne to levizin nga njerez e automjete me standart te larte sigurie e punimet ne keto tunele certifikohen sipas standarteve europiane te sigurise rrugore kurse tunelet hidroteknike nuk kane keto standarte sigurie.*

Per sa me siper, dokumentacioni I paraqitur nga operatori per deshmuar eksperienca të ngjashme të mëparshme ( tunel hidroteknik )nuk mund te behet vetëm në titullin apo objektin e kontratës së ngjashme por referuar standarteve e zerave te punes qe parashikon tuneli tokesor sic parashikon kontrata object prokurimi, nuk deshmon plotesimin e pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim .

Per sa me siper , mbeshtetur ;



Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*”.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”..*

*Oferta e BO Gener 2 shpk & Infrakonsult & Seed Consulting shpk , skualifikohet .*

#### **4. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “PE VLA KU” & “A L T E A shpk & GEO Studio 2000” & “TAULANT” & “SPHAERA” , rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

a. Operatori PE VLA KU shpk qe sipas akt marreveshjes bashkupinimit ka marre persiper te kryeje te gjitha punimet e zbatimit ose 98.5 te totalit te preventivit , nuk ka arritur te deshmoje se ploteson piken 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim,( nuk ka arritur te paraqese kontrata per te deshmuar se ka experience te ngjashme per ndertim tuneli )

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri operatori PE VLA KU shpk ka paraqitur disa kontrata por qe ne ansje prej tyre nuk ka zera punimesh per ndertim tuneli tokesor ne standartin e kerkuar ne termat e references.

Krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme ose jo nuk ka të bëjë vetëm me titullin e objektit të kontratës apo emertimin e zerit të punimeve por duhet parëe analizuar në lidhje me zërat konkretë të punimeve të relizuara nga operatori ekonomik. Në rastin konkret vetëm një sasi e pakonsiderueshme e zërave të kontratave të paraqitura nga operatori PEVLAKU shpk mund të konsiderohen të ngjashme me zërat e preventivit të kontratës objekt prokurimi e cila është e një natyre specifike dhe kërkon nga operatorët ekonomikë pjesmarrës që të kenë kryer eksperiencën të ngjashme me të njëjtën tipologji punimesh me kontratën në fjalë.

KVO gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet dhe eksperiencën e nevojshme për punë të ngjashme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim KVO nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por analizon në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret për kualifikim.



Ne kete aspect , operatori nuk deshmon se ka kryer punime te natyres ngjashme per ndertim tuneli tokesor duke mos krijuar kështu bindjen e autoritetit kontraktor për realizmin me sukses të kësaj kontrate.

1.2 Operatori PE VLA KU shpk qe sipas akt marrveshjes bashkupinimit ka marre persiper te kryeje 98.5 % te puneve, nuk permbush piken 2.2.1 te kriterereve te vecanta per kualifikim.

Kjo sepse vertetimi I paraqitur nr T01114030 dt 11.06.2019 ku deshmohet xhiro e realizuar per tre vitet fundit leshuar nga Drejtoria Tatimore, rezulton se ,mesatarja e tyre eshte me e vogel se sa duhet te kishte ne proporcion me % e marre persiper ne aktmarreveshje.

1.3 Operatori PE VLA KU shpk nuk ka arritur te deshmoje se ploteson piken 2.3.2 te kriterereve te vecanta per kualifikim , persa I perket nr mesatar te fuqise punetore per periudhen e kerkuar ne DT ne proporcion me % e marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit . Sipas vertetimit te paraqitur nga operatori nr T 01104990 date 27.05.2019 , e leshuar nga drejtoria tatimore , rezulton se nr pemastar I punonjesve pe roperatorin PE VLA KU shpk eshte 82 punonjes nderkohe qe sipas % se marre persiper duhet te kishte se paku 125 punetore.

1.4 Asnje prej operateve qe disponojne license ne fushen e projektimit nuk ka arritur te deshmoje plotesimin e pikes 2.3.6 te kriterereve te vecanta per kualifikim , per sa i perket dokumentacionit qe te deshmonet se ka kryer sherbime te ngjashme per projektim ne natyren qe permban kontrata object prokurimi.

Keshtu , as operatori Sphaera shpk dhe as Taulant shpk qe sipas akt marreveshjes mes tyre nr 1146 prot date 03.06.2019 ku kane marre persiper te kryejne sherbimin e parashikuar nga pika 7/e I licenses se projektimit,perkatesiht ne raportin 40 ; 60 , nuk ka arritur te paraqesin kontrata te ngjashme per realizmin te sherbimit per projektim tuneli tokesor .

Per sa me siper , mbeshtetur ;

Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”..

Oferta e BO PE VLA KU shpk & A L T E A shpk & GEO Studio 2000 shpk & TAULANT shpk & SPHAERA shpk , skualifikohet .





\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve “ **Gjoka Konstruksion**” & “**Cobial**” & “**Gr Albania**” & “**Geoportal**” , me adrese **Rruga “Dora D’Istria” Hyrja 1 dhe Hyrja 2, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.789.598.000** (një miliard e shtateqind e tetedhjetë e nente milion e peseqind e nentedhjetë e tete mijë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 223448, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[diferenca e ofertes ndermjet vendit te pare me te dyte eshte me e madhe se 2% e fondit limit]**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.06.2019

Ankesa : Ankesa Po. Ka marre pergjigje date 27.06.2019. dhe 28.06.2020 . KPP vendim nr. 510/2019,date 01.08.2019 dhe Vendimin 260/2020, date 17.07.2020 heqje e pezullimit sipas Vendimin nr.260/5/2020, date 24.07.2020.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ergys Verdho**

